

RRETH PROJEKTIT

“Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale.”



I përkrahur nga donatori

“Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
GmbH ”

i mandatuar nga

Qeveria e
Republikës Federale
të Gjermanisë.



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Për informata :

IADK

Adresa :

Fshati : Sfaraçak i Ulët, nr.11,

42000 Vushtrri,

Kosovë

*Tel : +377(0) 44 777 036
+ 386(0) 49 777 046*

E-mail : info@iadc.org

Web faqe : www.iadc.org

Përkrahja e 105 përfituesëve me grante



Përkrahur nga:

giz Initiative for International
Cooperation

Informata për projektin

Qëllimi i projektit është gjenerimi i të ardhurave dhe trajnimi i riatdhesuarve dhe familjeve në zonat rurale. Projekti do të trajtojë papunësinë, duke i targetuar personat e riatdhesuar me prioritet: gratë, minoritetet dhe personat më aftësi të kufizuara.

Projekti ka për qëllim të krijojë kushte për aktivitete bujqësore apo biznesore, të cilat mundësojnë krijimin e të hyrave dhe përmirsojnë gjendjen socio-ekonomike të popullatës, sidomos në zonat rurale të Kosovës, ku do të ketë shtrirje ky projekti.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 22 muaj, nga shtatori 2018 deri në qershor 2020.

Projekti do të ketë shtrirje në këto komuna të Kosovës: **Skënderaj, Drenas, Malishevë, Rahovec dhe Klinë.**

Grupet e synuara të projektit: Të riatdhesuarit që kanë gjendje të rëndë ekonomike, e posedojnë parakushte për t'u marr me bujqësi, të cilët nuk janë përkrahur më parë me ndonjë projekt nga qeveria, komuna apo donator tjerë.

IADK do të përkrah përfituesit në procesin e marketingut dhe legalizimit të bizneseve të reja, në procesin e rregjistrimit të fermave ose në shoqata. Ekspertët tanë do të këshillojnë përfituesit mbi tregun (pikat e shitjes) në mënyrë që ta lehtësojnë shitjen në bazë të kërkesave dhe standarteve nga blerësit.

Ku mbahen sesionet informuese?

IADK do të promovojë projektin nëpërmjet seancave informuese që do të mbahen në komunat ku do të zbatohet projekti.

Kush do të jenë përfituesit e granteve?

Përfitues të këtyre granteve do të jenë 105 fermer që jetojnë në viset rurale me nivel të ulët të ardhurave dhe gjendje jo të mirë ekonomike, të riatdhesuar, të cilët kanë kushte mesatare të punës në bujqësi, tokë, ujë dhe fuqi punëtore, ndërsa nuk kanë përfituar më parë ndonjë projekt. Përparësi kanë femrat, grupet e marginalizuara dhe minoritetet të interesuar në sektorin e bujqësisë.

Sa është shuma e granteve për përfitues?

Mesatarisht vlera e grantit për një përfitues do të jetë rreth 2400 €, në formë të mirave materiale si serra, pajisje mekanizëm dhe impute tjera sipas aplikacioneve dhe kërkesave të tyre, përfituesi do të bashkëfinancojë projektin me rreth 400 €.

Nga përvoja e stafit të IADK-së ka disa sektorë fitimprurës që do të propozohen e diskutohen me aplikantët. Fokusi do të jetë në pemë dhe perime, përpunim të ushqimit dhe blegtori.

Aplikuesi mund të propozojë ide atraktive për grant dhe ekspertët e IADK do ta shqyrëtojnë atë ide dhe potencialin e saj. IADK do të kryej blerjet dhe furnizimet për përfituesit e granteve.

Kur do të filloj aplikimi për grante?

Gjatë implementimit të projektit, në fund të muajit nëntor 2018 do të bëhen shpalljet nëpër komuna dhe përmes veb faqes së IADK-së do të shpërndahen informacionet për kohën dhe vendin e aplikimit për grante dhe do të organizohen sesione informuese.

Ku duhet të aplikohet për grante?

Fermerët e interesuar për aplikim do të mund t'i marrin aplikacionet në departamentet komunale tek koordinatoret e zyrave komunale për kthim dhe komunitete në komunat ku ka shtrirje projekti, apo edhe direkt në zyrat e IADK-së dhe web faqen (www.iadk.org), dhe pas plotësimit dokumentacionet e kërkuara më aplikacion dorëzohen tek koordinatoret e zyrave komunale për kthim dhe komunitete apo në IADK.

Si bëhet përzgjedhja e përfituesve?

Pas pranimit të aplikacioneve një komision i përbashkët i ekspertëve të IADK-së dhe komunës përkatëse nga janë aplikuesit, do të del në teren për të bërë përzgjedhjen e përfituesve në bazë të kritereve të poentimit.

Kur do të shpërndahen grantet?

Grantet do të jepen për idetë e përfituesve që kanë kthim më të shpejtë të investimeve, janë më të qëndrueshme, pa ndotje të mjedisit, si dhe projektet që rrisin sigurinë e ushqimit. Furnizimet do të bëhen me kohë për të zënë sezonën e prodhimit në bujqësi duke filluar nga fundi i vitit 2018.

Si do të organizohen trajnimet për përfituesit?

Të 105 përfituesit e përzgjedhur do të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga IADK mbi mbajtjen e shënimeve dhe marketing si dhe menaxhimin e fermës. Ata do të monitorohen nga ekspertët të IADK-së në fermat e tyre dhe ku do të mbahen edhe këshillimet të drejtpërdrejta në varësi të sektorit. Për të gjithë përfituesit e projekti do të organizohen vizita studimore në Kosovë dhe regjion më qëllim të shkëmbimit të përvojave.